




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 531/2023
Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragraf 1, pika 1.14, dhe 1.25, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 dhe 7, të Ligjit 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur në ankesën disiplinore të Ali Shabani nga Gjilani, ndaj vendimit GJS-2023-022, i datës 26.09.2023, të Autoritetit Kompetente të Gjykatës Supreme, në mbledhjen e 317-të, të mbajtur me datë 27 nëntor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

Hedhet si e pa lejuar ankesa disiplinore e paraqitur nga Ali Shabani nga Gjilani kundër vendimit GJS-2023-022, të datës 26.09.2023, të nxjerr nga Autoriteti Kompetent i Gjykatës Supreme z.Fejzullah Rexhepi.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar ankesë urgjente nga Ali Shabani për inicim të procedurës disiplinore ndaj Autoritetit Kompetent të Gjykatës Supreme të Kosovës z.Fejzullah Rexhepi, me rastin e nxjerrjes së vendimit GJS-2023-022, të datës 26.09.2023, me të cilin vendim është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e ankuesit të njëjtë për inicim të procedurës ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan z.Venhar Salihu.

Ankuesi në këtë çështje pretendon se vendimi i Autoritetit Kompetent të Gjykatës Supreme GJS-2023-022, i datës 26.09.2023, është me përmbajtje absurde, i mungon arsyetimi logjik dhe zbatimi i ligjit, dhe rrjedhimisht epilogu i këtij aktvendimi është shkelje e qëllimshme e ligjit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 27 nëntor 2023, pasi e shqyrtoj ankesën urgjente të ankuesit z.Ali Shabani nga Gjilani dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 7, paragraf 1, pika 1.14, dhe 1.25, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 dhe 7, të Ligjit 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa urgjente e paraqitur nga Ali Shabani nga Gjilani, për inicim të procedurës disiplinore të Autoritet Kompetente të Gjykatës Supreme z.Fejzullah Rexhepi me rastin e nxjerrjes së vendimit GJS-2023-022, të datës 26.09.2023, është e pa lejuar.

Në këtë drejtim, Ligji 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i ka dhënë mundësin secilit person fizik dhe juridik që të parashtrij ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo të Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën t'a përcjell tek Autoriteti Kompetent, mirëpo nuk ja ka dhanë mundësinë ligjore personave fizik dhe juridik që të parashtrij ankesë ndaj vendimit të Autoritetit Kompetent tek Këshilli kur Autoriteti Kompetent e ka refuzuar ankesën disiplinore, sepse për këtë veprim është i autorizuar vetëm Avokati i Popullit.

Në këto rrethana, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vlerësuar ankesën e parashtruar se bashku me shkresat e bashkuara sa i përket pretendimeve ndaj vendimit GJS-2023-022, të datës 26.09.2023, i nxjerr nga Autoritetit Kompetent të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës z.Fejzullah Rexhepi konstatoj qe ankesa **është e pa lejuar**.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.531/2023, datë: 27 nëntor 2023

Albert ZOGAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Ali Shabani, Rr. "Lekë Dukagjini", nr.38,Gjilan
- Fejzullah Rexhepi, Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.